

Titulli i temës së Masterit:

‘‘Veprimtaria e Përfaqësive Konsullore të Republikës së Kosovës sipas legjislacionit pozitiv’’

**Kandidati: Lavdim Morina**

**Mentori: Prof.Dr. Asllan Bilalli**

### **Abstrakt**

Përfaqësitë Konsullore të Republikës së Kosovës në botë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përfaqësim të interesave të shtetit në drejtim të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike, kulturore, politike, shkencore, mbrojtjen e interesave të shtetit dhe të drejtat e shtetasve në vendin ku është i akredituar Misioni Konsullor i Republikës së Kosovës. Ushtrimi i funksioneve Konsullore të Republikës së Kosovës bazohet në akte ligjore ndërkombëtare, në veçanti në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, marrëveshjet e Republikës së Kosovës me shtetin pritës, ligjet dhe aktet tjera nenligjore të zbatueshme në Kosovë, si dhe ligjet dhe aktet ekzistuese në rrethin konsullor.

Republika e Kosovës që nga shpallja e pavarësisë më datë 17.02.2008 e deri më sot ka gjithsej 33 Misione Konsullore në botë, njëzet e një (21) Konsullata (18 prej tyre në kuadër të ambasadave), dhe dymbëdhjetë (12) Konsullata të Përgjithshme. Shumica e Përfaqësive Konsullore të Republikës së Kosovës janë të vendosura në ato pjesë ku ka përqëndrim më të madh të diasporës, por edhe në ato pjesë me rëndësi më të madhe ekonomike, politike dhe ndonjë interes tjetër shtetëror.

Në kuadër të partneritetit strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, në mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive, të mbajtura në Prizren më datë 11 janar 2014, në deklaratën e nënshkruar për bashkëpunim dhe partneritet strategjik, është bërë propozimi për përfaqësimin e përbashkët konsullor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Në këtë drejtim, Konsullata e parë e përbashkët midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë u inaugurua më datë 16 shtator 2014 në Milano të Italisë , ndjekur nga Konsullatat e përbashkëta në Mynih të Gjermanisë, dhe më vonë edhe në Kopenhagën të Danimarkës.

Fjalët kyqe: Funksionet konsullore, veprimtaria administrative, diplomacia ekonomike dhe kulturore, etj.

## **Abstract**

The Consular Representations of the Republic of Kosovo in the world play a very important role in representing the interests of the state in terms of developing economic, cultural, political, scientific relations, protection of state interests and the rights of citizens in the country where the Consular Mission is accredited.

The exercise of Consular functions of the Republic of Kosovo is based on international legal acts, in particular the Vienna Convention on Consular Relations of 1963, agreements of the Republic of Kosovo with the host state, laws and other bylaws applicable in Kosovo, as well as laws and existing acts in the consular district.

The Republic of Kosovo since the declaration of independence on 17.02.2008 until today has a total of 33 Consular Missions in the world, twenty-one (21) Consulates (18 of them within embassies), and twelve (12) Consulates General.

Most of the Consular Representations of the Republic of Kosovo are located in those parts where there is a greater concentration of the diaspora, but also in those parts of greater economic importance and other state interest.

As part of the strategic partnership between the Republic of Kosovo and the Republic of Albania, in the joint meetings of the two governments, held in Prizren on January 11, 2014, in the Declaration signed for cooperation and strategic partnership, was made a proposal for joint consular representation between the Republic of Kosovo and the Republic of Albania.

In this regard, the first joint Consulate between Kosovo and Albania was inaugurated on September 16, 2014 in Milan, Italy. Followed by Joint Consulates in Munich, Germany and later in Copenhagen, Denmark.

**Keywords:** Consular functions, administrative activity, economic and cultural diplomacy, etc.